




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-16240/23 datë: 30.06.2023



Npi – 01/275 datë: 04.07.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 04.07.2023 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Reshat Gashi, znj.Gentiana Mehmeti, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, praktikantet znj.Sadbere Halili, dhe znj.Valmira Hoxha.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. **Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.06.2023, (Shtyhet)**
2. **Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025 (Pas diskutimit publik)**
3. **Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem që pika e 1 pocesverbali të shtyhet.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës pa pikën 1.**

Pika 1

Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025
(Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroi se programi 3 vjeçar për banim social, ka shku në diskutim publik dhe diskutimi publik është mbajtur më 29.06.2023 dhe nuk ka pasur ndonjë propozim për ndryshim. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Pajtohem me këtë plan sepse unë kamë qenë në Komision vitin e kalur dhe mendojë që është në të mirën e të gjithëve.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Draft-Programit tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025.**

Pika 2

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lidhur me këtë pikë asnjëherë nuk po mund të votohet ashtu siç e ka thënë MAPL-ja, tash po mendojë që ndodhta është mirë me shty për muajin gusht dhe me u ul me bisedu bashkarisht dhe me gjetë zgjidhje me grupet parlamentare. Po ashtu duhet të bisedojmë edhe me Komunitet tjerë për mundësinë e pagesës për Komitetet tjerë. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem për me u shty kjo pikë për muajin Gusht, kërkojë që Komiteti të bëhet në bazë të ligjit por me një marrëveshje të përbashkët që po na mungon.

z.Kadri Emini; Përsëritet, pajtohem me e shty këtë pikë, unë jam i pajtimit që në Kuvend me qenë një vendim formal. Ne duhet të shikojmë ligjin sepse mundësi tjetër nuk kemi përveç se me zbatu ligjin. Kërkojë që deri në Gusht me gjetë formulën dhe jamë i bindur se do të jetë 3-3-1. Mendojë se tani është një zgjidhje për me u shty.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, shtyrjen e shqyrtimit të kësaj pike deri në mbledhjen e Kuvendit për muajin Gusht-2023, me arsyetimin që grupet parlamentare të gjejnë një dakordim të përbashkët për këtë pikë të rendit të ditës.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi diskutime të tjera nuk kishte mbledhjen e përfundoi në ora 09:29h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

